

	KONKURS PUBLIK	DT-BNJ-027
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 1 nga 3</i>
Departamenti i Burimeve Njerëzore		Spektori i Personelit

Bazuar në Nenin 21, paragrafi 21.1 dhe 21.4 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligji Nr.04/L-111, për ndryshim plotësimin e Ligjit Ligji nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligjin Nr. 05/L -009 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-111, Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e mbajtur me datë 21.11.2025, mori vendim të shpall:

KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e vendit të lirë të punës

Kryeshef Ekzekutiv

Kushtet e përgjithshme:

Në tekstin në vijim përdorimi i njërës gjini nuk përjashton gjininë tjetër.

Orari i punës: Puna me orar të plotë.

Paga: Lartësia e pagës do të përcaktohet në harmoni me politikat e aprovuara të KOSTT-it.

Kohëzgjatja e punësimit: Me mandat katërvjeçar(4 vite)

Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën: Kryeshef Ekzekutiv

Nr.referues i pozitës: 1.0.0.0

Kryeshefi Ekzekutiv është përgjegjës për udhëheqjen e suksesshme të kompanisë në arritjen e objektivave strategjike të përcaktuara për KOSTT-in, në përputhje me kërkesat ligjore dhe praktikë më të mira profesionale. Ai duhet ta përfaqësojë kompaninë para publikut, autoriteteve qeveritare dhe organizatave ndërkombëtare.

Kryeshefi Ekzekutiv i përgjigjet Bordit të Drejtorëve dhe mbikëqyr punën e tërë kompanisë dhe të menaxhmentit të saj, veçanërisht të Zëvendës Kryeshefit Ekzekutiv, Drejtorëve të Departamenteve dhe Menaxherëve të Zyrave.

Detyrat specifike:

Menaxhimi i përgjithshëm

Kryeshefi Ekzekutiv koordinon zhvillimin e afarizmit të KOSTT-it, ndërsa detyrat dhe përgjegjësitë e tij specifike janë që të:

- Drejtojë zhvillimin e planit të biznesit dhe të menaxhojë implementimin e tij;
- Sigurojë që KOSTT-i të ketë resurse të mjaftueshme në aspektin financiar, të personelit të kualifikuar dhe pajisjeve;

- Vendosë sisteme dhe procedura për menaxhimin efektiv të KOSTT-it;
- Mbikëqyrë aktivitetet e drejtorëve dhe menaxherëve që i raportojnë drejtpërdrejt atij;
- Kontribuoj në zhvillimin e një strategjie efektive për KOSTT-in;
- Sigurojë që performanca e KOSTT-it të jetë e kënaqshme në aspektin teknik dhe financiar;
- Kontribuoj në avancimin e performancës së KOSTT-it në raport me misionin, objektivat, planin dhe buxhetin, si dhe adaptojë masa përmirësuese sipas nevojës;
- Sigurojë gatishmërinë dhe besueshmërinë e sistemit të transmisionit në furnizimin me energji elektrike;
- Lehtësojë zhvillimin dhe operimin e tregut të energjisë elektrike në Kosovë;
- Mbajë komunikim efektiv me Qeverinë, ZRrE-në, kompanitë e sektorit të energjisë në Kosovë dhe palët e tjera relevante të interesit, përfshirë organizatat ndërkombëtare;
- Sigurojë që KOSTT-i t'u përmbahet të gjitha ligjeve dhe rregulloreve relevante;
- Mbikëqyrë punën ligjore të KOSTT-it dhe aprovojë përfaqësimin e KOSTT-it në kontestet ligjore;
- Paraqesë Bordit të Drejtorëve për miratim politikat, rregulloret përkatëse dhe Kodin e Etikës, t'i mbajë ato nën rishikim dhe, sipas nevojës, t'i paraqesë për revizion;
- Nxjerrë procedura, rregullore, urdhëresa dhe akte të tjera të kompanisë;
- Përfaqësojë KOSTT-in në publik, përfshirë komunikimet me median dhe deklaratat për shtyp;
- Përcaktojë çështjet organizative për drejtorët e departamenteve dhe menaxherët e tjerë;
- Përgatisë raporte tremujore dhe vjetore për aktivitetet afariste për miratim dhe rishikim nga Bordi i Drejtorëve;
- Sigurojë implementimin e vendimeve të Bordit të Drejtorëve;
- Kryejë detyra të tjera që Bordi i Drejtorëve i konsideron të përshtatshme, të nevojshme për funksionimin efektiv të KOSTT-it dhe që janë në pajtim me ligjin dhe Librat e Rregullave të KOSTT-it.

Në kryerjen e detyrave të tij, Kryeshefi Ekzekutiv bashkëpunon ngushtë me anëtarët e tjerë të Ekipit Menaxhues. Ai u delegon detyra anëtarëve dhe punëtorëve të KOSTT-it, sipas rastit, por mbron përgjegjësinë kryesore për të gjitha aspektet e performancës së kompanisë.

Kualifikimet dhe aftësitë

- Përmbushja e kriterëve për zyrtarë të kompanisë sipas Ligjit për Ndërmarrjet Publike (si është amandamentuar dhe plotësuar), përkatësisht: (i) plotësimi i kushteve të kualifikimit sipas nenit 17.1; (ii) plotësimi i kriterëve të pavarësisë sipas nenit 17.2, pikat (d), (f), (j), (k) dhe (l); dhe (iii) posedimi i përvojës profesionale dhe arsimimit të nevojshëm për pozitën përkatëse;
- Diplomë universitare (niveli Master ose Doktoraturë konsiderohen përparësi) preferohet Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike
- Përvojë më së paku 7 vite pune në pozita udhëheqëse; përvoja në sektorin e energjisë konsiderohet përparësi;
- Aftësi të dëshmuara menaxhuese;
- Njohuri të thella për industrinë e shërbimeve publike në nivel vendor dhe ndërkombëtar;
- Njohuri të mira mbi çështjet rregullative që lidhen me sektorin e energjisë;
- Njohuri të mira të ligjeve dhe rregulloreve në fuqi, veçanërisht për Ligjin për Ndërmarrjet Publike, Ligjin për Shoqëritë Tregtare, Ligjet për Energji dhe aktet përkatëse të Bashkimit Evropian për energjinë;
- Aftësi të shkëlqyera komunikuese;
- Njohje e shkëlqyeshme e gjuhës angleze, me shkrim dhe në të folur;
- Aftësi organizative dhe koordinuese.

Aplikimi

Për pozitën e shpallur, aplikimet do të pranohen vetëm nga kandidatët të cilët i plotësojnë kërkesat e përcaktuara në konkurs.

Vlerësimi formal i kandidatëve dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit për aplikim.

KOSTT e mban të drejtën për të formuar listën e shkurtuar të aplikantëve në harmoni me politikat e kompanisë.

Kandidatët që ftohen për intervistim duhet të kenë me vete të gjitha dokumentet që dëshmojnë të dhënat e përfshira në aplikacion, në rast se Komisioni Përzgjedhës vendos t'i kërkojë dokumentet për shqyrtim, kandidatët duhet t'i paraqesin ato sipas kërkesës. Nga kandidatët e përzgjedhur për intervistim, para zhvillimit të intervistës, mund të kërkohej gjithashtu paraqitja e Deklaratës së Interesit për aplikim në pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv, duke përfshirë edhe vizionin e tyre për menaxhimin e KOSTT-it.

Forma e aplikimit

- Aplikimi për pozitën e shpallur bëhet vetëm në formë elektronike, duke plotësuar aplikacionin që mund të shkarkohet nga web faqja e KOSTT-it: <https://kostt.com/Home/WorkingForKOSTT>.
- Kandidatët, së bashku me aplikacionin, duhet të dorëzojnë/bashkëngjisnin dokumentet që dëshmojnë përvojën e punës, kualifikimet (kontrata, vërtetime, referenca nga punëdhënësi apo ndonjë dëshmi tjetër relevante e cila mund të jetë e plotësuar me pasqyrë të kontributeve në trust,) si edhe certifikatën mbi dënimet penale që nuk është i dënuar me aktgjykim të formës së prerë jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj. Komisioni Përzgjedhës ruan të drejtën e kërkesës së dokumenteve dhe informatave shtesë nga aplikantët.
- Gjithashtu, kandidatët duhet t'i dorëzojnë një deklaratë nën betim, të nënshkruar nga vete kandidati, se i plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.1 dhe 17.2, forma mund të shkarkohet nga ueb faqja e KOSTT-it:
https://kostt.com/Content/ViewFiles/WorkingForKOSTT/Deklarata_nen_betim_Kryeshef_Ekzekutiv_KOSTT.doc

Çdo përgënjeshttrim material, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca, ose çdo ndryshim material nga informacionet e dhëna në deklaratën e sipërpërmendur, do të rezultojë në mos kualifikim të menjëhershëm, dhe, në rast të aplikueshëm, largimin e personit nga procesi i përzgjedhjes.

E-mail adresa ku duhet të aplikohet është: punesimi.znp@kostt.com

Afati i aplikimit është nga data 25.11.2025 deri me datë 15.12.2025 në ora 23:59.

Aplikacionet pas afatit të paraparë nuk do të pranohen.

KOSTT ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës si dhe inkurajon kandidatët e gjinisë femërore, të rinjtë dhe pjesëtarët e komuniteteve që të aplikojnë për këtë pozitë pune.

	JAVNI KONKURS	DT-BNJ-027
	<i>ver. 1.0</i>	<i>strana 1 od 3</i>
<i>Departman za ljudske resurse</i>		<i>Sektor za osoblje</i>

Na osnovu člana 21., stav 21.1 i 21.4 Zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima, Zakona br. 04/L-111, o izmeni i dopuni Zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima, Zakona br. 05/L-009 o izmeni i dopuni Zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima, izmenjenog i dopunjenog Zakonom br. 04/L-111, Odbor direktora je, na sednici održanoj dana 21.11.2025., doneo odluku da raspisa:

JAVNI KONKURS

Za popunjavanje slobodnog radnog mesta

Glavni izvršni direktor

Opšti uslovi:

U tekstu u nastavku, upotreba jednog roda ne isključuje drugi rod.

Radno vreme: Puno radno vreme.

Plata: Visina plate biće utvrđena u skladu sa odobrenim politikama KOSTT-a.

Trajanje zaposlenja: Na četverogodišnji mandat (4 godine).

Opis radnih dužnosti za poziciju: Glavni izvršni direktor

Referentni br. pozicije: 1.0.0.0

Glavni izvršni direktor je odgovoran za uspešno vođenje kompanije u postizanju strateških ciljeva utvrđenih za KOSTT, u skladu sa zakonskim zahtevima i najboljim stručnim praksama. On mora predstavljati kompaniju pred javnošću, vladinim autoritetima i međunarodnim organizacijama.

Glavni izvršni direktor odgovara Odboru direktora i nadgleda rad cele kompanije i njenog menadžmenta, posebno zamenika glavnog izvršnog direktora, direktora departmana i menadžera kancelarija.

Specifične dužnosti:

Opšte upravljanje

Glavni izvršni direktor koordinira razvoj poslovanja KOSTT-a, dok njegove specifične dužnosti i odgovornosti su da:

- Rukovodi razvojem biznis plana i upravlja njegovom implementacijom;
- Obezbedi da KOSTT ima dovoljno resursa u finansijskom aspektu, kvalifikovanog osoblja i opreme;
- Uspostavi sisteme i procedure za efektivno upravljanje KOSTT-om;
- Nadgleda aktivnosti direktora i menadžera koji mu direktno izveštavaju;

- Doprinese razvoju efektivne strategije za KOSTT;
- Obezbedi da je učinak KOSTT-a zadovoljavajući u tehničkom i finansijskom aspektu;
- Doprinese unapređenju učinka KOSTT-a u odnosu na misiju, ciljeve, plan i budžet, kao i usvoji mere za poboljšanje po potrebi;
- Obezbedi spremnost i pouzdanost prenosnog sistema u snabdevanju električnom energijom;
- Olakša razvoju i radu tržišta električne energije na Kosovu;
- Vodi efektivnu komunikaciju sa Vladom, RUE, kompanijama energetskog sektora na Kosovu i drugim relevantnim zainteresovanim stranama, uključujući međunarodne organizacije;
- Obezbedi da se KOSTT pridržava svim relevantnim zakonima i propisima;
- Nadgleda KOSTT-ov pravni rad i odobri KOSTT-ovo zastupanje u pravnim sporovima;
- Podnosi Odboru direktora na usvajanje politike, odgovarajuće propise i Kodeks etike, da ih drži pod revizijom i, po potrebi, podnosi za reviziju;
- Donosi procedure, propise, naredbe i druge akte kompanije;
- Zastupa KOSTT u javnosti, uključujući komunikacije sa medijima i izjave za štampu;
- Utvrđuje organizaciona pitanja, direktora departmana i ostalih menadžera;
- Priprema tromesečne i godišnje izveštaje o poslovnim aktivnostima na usvajanje i pregled od Odbora direktora;
- Obezbedi implementaciju odluka Odbora direktora;
- Obavlja druge dužnosti koje Odbor direktora smatra prikladnim, potrebnim za efektivno funkcionisanje KOSTT-a i koje su u skladu sa zakonom i Knjigama pravila KOSTT-a.

U obavljanju svojih dužnosti, Glavni izvršni direktor blisko sarađuje sa drugim članovima Upravnog tima. On delegira dužnosti članovima i zaposlenicima KOSTT-a, prema slučaju, ali čuva glavnu odgovornost za sve aspekte učinka kompanije.

Kvalifikacije i sposobnosti

- Ispunjavanje kriterijuma za službenike kompanije prema Zakonu o javnim preduzećima (kao što je izmenjen i dopunjen), odnosno: (i) ispunjavanje uslova kvalifikacije prema članu 17.1; (ii) ispunjavanje kriterijuma nezavisnosti prema članu 17.2, tačaka (d), (f), (j), (k) i (l); i (iii) posedovanje stručnog iskustva i obrazovanja potrebnog za odgovarajuću poziciju;
- Univerzitetska diploma (nivo Master ili Doktora se smatra prednošću) poželjan je Fakultet električnog inženjerstva.
- Iskustvo najmanje 7 godina rada na rukovodećim pozicijama; iskustvo u energetskom sektoru se smatra prednošću;
- Dokazane menadžerske sposobnosti;
- Duboko znanje za industriju javnih usluga na domaćem i međunarodnom nivou;
- Dobro znanje o regulatornim pitanjima koja se vežu za energetski sektor;
- Dobro poznavanje zakona i propisa na snazi, posebno o Zakonu o javnim preduzećima, Zakonu o poslovnim društvima, Zakonima o energetici i odgovarajućim aktima Evropske unije o energetici;
- Odlične sposobnosti komunikacije;
- Odlično poznavanje engleskog jezika, u pisanju i govoru;
- Organizacione i koordinacione sposobnosti.

Apliciranje

Za raspisanu poziciju, aplikacije biće primljene samo od kandidata koji ispunjavaju zahteve utvrđene u konkursu.

Formalno ocenjivanje kandidata i intervjui biće obavljeni nakon isteka roka za apliciranje.

KOSTT zadržava pravo da formira skraćeni spisak aplikanata u skladu sa politikama kompanije.

Kandidati koji budu pozvani na intervjuisanje moraju sa sobom imati sve dokumente koji dokazuju podatke uključene u aplikaciji, u slučaju da Komisija za odabir odluči zatražiti dokumente na razmatranje, kandidati ih moraju predložiti na zahtev. Od kandidata odabranih za intervjuisanje, pre odvijanja intervjua, može se tražiti takođe prikazivanje Izjave o interesu za apliciranje na poziciju Glavnog izvršnog direktora, uključujući i njihovu viziju o upravljanju KOSTT-om.

Obrazac za apliciranje

- Apliciranje za raspisanu poziciju vrši se samo u elektronskom obliku, popunjavajući aplikaciju koja se može preuzeti sa web stranice KOSTT-a: <https://kostt.com/Home/WorkingForKOSTT>.
- Kandidati, zajedno sa aplikacijom, moraju dostaviti/priložiti dokumente koji dokazuju radno iskustvo, kvalifikacije (ugovore, potvrde, reference od poslodavca ili bilo koji drugi relevantni dokaz koji se može dopuniti izjavom o doprinosima u trustu), kao i sertifikat o krivičnim osudama da nije osuđen pravosnažnom presudom ne stariji od šest (6) meseci. Komisija za odabir zadržava pravo zahtevanja dodatnih dokumenata i informacija od aplikanata.
- Kandidati takođe moraju dostaviti izjavu pod zakletvom, potpisanu od samog kandidata, da ispunjavaju kriterijume nezavisnosti prema članu 17.1 i 17.2 (obrazac se može preuzeti sa web stranice KOSTT-a: https://kostt.com/Content/ViewFiles/WorkingForKOSTT/Deklarata_nen_betim_Kryeshef_Ekzekutiv_KOSTT.doc).

Svako materijalno lažno predstavljanje, bilo namerno ili iz nemara, ili bilo kakva materijalna promena od informacija datih u gore navedenoj izjavi, rezultiraće neposrednom diskvalifikacijom i, u primenljivom slučaju, uklanjanjem lica iz procesa odabira.

E-mail adresa gde se treba aplicirati je: punesimi.znp@kostt.com.

Rok za apliciranje je od dana 25.11.2025. do dana 15.12.2025. u 23:59 časova.

Aplikacije nakon predviđenog roka neće se primiti.

KOSTT pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Republike Kosova kao i ohrabruje kandidate ženskog roda, mlade i članove zajednica da apliciraju za ovu radnu poziciju.